REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:106993
Datë: 31.01.2020
Numri i dokumentit: 00798953

P.nr.600/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Fidan Hoxha, me sekretaren juridike Ardijana Reshtani, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.I nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275, par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.843-13/19 të datës 17.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në seancën publike, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi, të akuzuarit F.I dhe mbrojtësit të tij av. Q.G, me datë 28.01.2020 mori dhe shpalli, ndërsa përpiloi me datë 31.01.2020 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.I, nga i ati M. dhe e ëma A., e lindur E., i lindur me datë ..., në Prizren, ku edhe tani banon në rr.” ...” nr.... ka të kryer fakultetin, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit ....

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 02.04.2017, rreth orës 00:45 policia gjatë patrullimit në rrugën ... saktësisht tek hyrja e spitalit rajonal Prizren, kanë ndaluar automjetin e tipit golf ngjyrë e kaltër me targa ..., të cilin e drejtonte i pandehuri dhe kanë rezultuar se i pandehuri F.I, posedon pa autorizim narkotik, e cila është gjetur në veturë një qese najloni e tejdukshme me bari ngjyrë e gjelbër e dyshuar me narkotik e llojit marihuan me peshë prej 0.81, gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 43, 46, 73, 74 dhe nenit 275, par.2 dhe 3 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

2019:106994

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të llogaritet me 20 euro të gjobës konform nenit 43 parag. 3 te KPRK-së.

Të akuzuarit, i konfiskohet një qese najloni me substancë narkotike marihuanë, me peshë 0.81 gram si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguajë shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.843-13/19 të datës 17.05.2019, ndaj të akuzuarit F.I nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së.

Me datë 17.05.2019, prokurori i shtetit ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, hartuar nga ana e prokurorit të shtetit në pajtim me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij av. Q.K nga Prizreni.

Në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e hartuar nga ana e prokurorit të shtetit me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij janë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku në mes tjerash është negociuar dhe propozuar dënimi për të akuzuarin. Në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në dispozitivin nën IV është rekomanduar dënimi me gjobë në shumën prej 250 euro.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se prokurori i shtetit ka lidhur marrëveshje me të pandehurin F.I me datë 17.05.2019 me nr. PP/II.nr.843-13/19. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është bërë në prezencë të mbrojtësit të tij, i njëjti ka hyrë në marrëveshje pa ndikim dhe është pajtuar që të shpallet fajtor për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve nga neni 275 par.2 të KP-së, dhe është pajtuar me dënimin e rekomanduar sikurse në pikën IV të marrëveshjes, andaj duke marrë parasysh ekonomizimin dhe faktin se marrëveshja është lidhur konform nenit 233 të KRPK-së kërkojmë nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.I, av. Q.K deklaroi se: gjatë konsultimit me të mbrojturin tim, të cilin e ka njoftuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, e cila është përpiluar konform dispozitave ligjore nga ana e prokurorit të çështjes. I ka propozuar gjykatës që ta aprovojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë në tërësi si dhe dënimin e rekomanduar.

2019:106994

I akuzuari F.I ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të mbrojtësit të tij.

Ndër të tjera gjatë shqyrtimit fillestar me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se me datë 02.04.2017, rreth orës 00:45 policia gjatë patrullimit në rrugën ... saktësisht tek hyrja e spitalit rajonal Prizren, kanë ndaluar automjetin e tipit golf ngjyrë e kaltër me targa ..., të cilin e drejtonte i pandehuri dhe kanë rezultuar se i pandehuri F.I, posedon pa autorizim narkotik, e cila është gjetur në veturë një qese najloni e tejdukshme me bari ngjyrë e gjelbër e dyshuar me narkotik e llojit marihuan me peshë prej 0.81, gram.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare në harmoni me nenin 257 të KPPK, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore e cila do të vente në dyshim dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë – marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të KPPK, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë shqyrtimit fillestar të marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç 'rast nga ana e të akuzuarit në mënyrë vullnetare është pranuar fajësia, pa kushtëzime, pa presione dhe askush nuk ka bërë premtim të kundërligjshëm i cili do t'i shtyjë në pranimin e marrëveshjes, por e gjithë kjo është bërë pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e neneve 233, 246 dhe 248 të KPPK. Gjykata gjithashtu nga i akuzuari ka vërtetuar se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e ka pranuar pa asnjë presion me vullnet të plotë dhe heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt. Sa i përket vendimit mbi dënimin prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, i propozuan gjykatës që të aprovojë dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 73 të KPK-së erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Andaj bazuar në rrethanat e lartë theksuara, gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha pikat e saja, me ç 'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e rekomanduar, ashtu që i shqiptojë dënimin me gjobë duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më e përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Të akuzuarit konform nenit 275, par. 3 i është konfiskuar një qese najloni me substancë narkotike marihuanë, me peshë 0.81 gram.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 paragrafi 1 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2019:106993, 31.01.2020

G j y q t a r i

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

2019:106994